

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KUVENDI POPULLOR**

**LIGJ**

**Nr. 7746 Date 28.07.1993**

**"PER HIDROKARBURET (KERKIMI DHE PRODHIMI)"**

Meqenese politika e Republikes se Shqiperise ka per qellim:

- (i) te nxise kerkimin dhe prodhimin e naftes dhe gazit natyror;
- (ii) te rehabilitoje paisjet ekzistuese dhe te rrise nxjerrjen e naftes dhe gazit nga rezervat tashme te zbuluara;
- (iii) te siguroje qe zhvillimi i ketyre rezervave te pakthyeshme behet ne perputhje me interesat kombetare, ne menyre te rregullt, ne perputhje me standartet e aplikueshme nderkombetare;
- (iv) te siguroje qe operacionet e hidrokarbureve nuk rrezikojne jeten njerezore apo i shkaktojne deme mjedisit,

Ne mbeshtetje te nenit 16. te Ligjit Nr.7491, date 29.04.1991, "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim te Keshillit te Ministrave,

## **KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

### **VENDOSI:**

#### **Neni 1.**

#### **Citimi**

Ky ligj citohet Ligji per Hidrokarburet (kerkimi dhe prodhimi), 1993.

#### **Neni 2.**

#### **Perkufizime**

Ne kete ligj vetem pervec rasteve kur konteksti e kerkon ndryshe,

"Albpetroli" do te thote Bashkesia Ekonomike e Naftes dhe Gazit.

"Gaz Natyror" do te thote gjithe Hidrokarburet qe jane ne gjendje te gazte ne kushte atmosferike normale duke perfshire gzin e lenget, gzin e thate, gzin ne hapsiren unazore dhe gzin mbetes qe mbetet pas nxjerjes apo ndarjes se Hidrokarbureve te lengeta nga gazi i lenget, dhe gazi johidrokarbur i prodhuar se bashku me hidrokarburet e lengshme dhe te gazta.

"Hidrokarbure" do te thote nafte bruto ose gaz natyror.

"Kerkim" do te thote kerkimi per hidrokarbure me mjete gjeologjike, gjeofizike e te tjera, dhe perfshin shpimin e puseve te kerkimit dhe vleresimit.

"Kontraktor" do te thote cdo person apo persona me te cilet Ministria hyn ne Marreveshje Hidrokarburesh, dhe mund te perfshije edhe Albpetrolin apo cdo agjenci tjeter shteterore.

"Ministria" do te thote Ministria e Industrise, Burimeve Minerare dhe Energetikes.

"Marreveshje Hidrokarburesh" do te thote nje marreveshje e lidhur nga Ministria ne perputhje me paragrafin 1 te nenit 5 te ketij Ligji, qe autorizon Kontraktorin te kryeje operacione ne Zonen e Kontrates dhe mund te marre formen e nje Marreveshje me Ndarje Prodhimi ose ndonje forme tjeter te rene dakort mes Ministrise dhe Kontraktorit e cila nuk eshte ne kundershtim me kete Ligj.

"Marreveshje me Ndarje Prodhimi" do te thote nje Marreveshje Hidrokarburesh, e cila parashikon mbulimin e Kostove te Kontrates nga Hidrokarburet e prodhuara ne Zonen e Kontrates ose nga pjese proporcionale te saj dhe ndarjen midis Shtetit dhe Kontraktorit te sasise te hidrokarbureve te mbetur pas mbulimit te Kostove te Kontrates ne perputhje me nje shkalle ose formule te percaktuar ne Marreveshjen e Hidrokarbureve.

"Nafte Bruto" do te thote nafte, asfalte, ozokerite, dhe gjithe llojet e hidrokarbureve dhe bitumeve, te ngurta dhe te lengta, ne gjendjen e tyre natyrore ose te perfutura nga gazi natyror nepermjet kondesimit apo nxjerrjes, por nuk perfshin qomyrgurin apo ndonje substance tjeter qe mund te nxirret nga qomyrguri.

"Operacione Hidrokarbure" do te thote te gjithe ose çdo operacion qe lidhet me kerkimin, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen dhe perpunimin, grumbullimin, transportimin dhe shitjen ose disponimin e Hidrokarbureve deri ne piken e eksportit ose ne nje pike livrimi ne Shqiperi per te cilen eshte rene dakort ose ne piken e hyrjes ne nje rafineri, dhe perfshin operacionet e perpunimit te gazit natyror, por nuk perfshin operacionet e rafinimit te hidrokarbureve.

"Plan zhvillimi" do te thote nje plan per zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve te zbuluar ne nje Zone Kontrate, i pergatitur ne perputhje me kerkesat e Nenit 6 te ketij Ligji dhe dispozitat perkatese te Marreveshes se Hidrokarbureve per kete zone kontrate.

"Praktika te mira te vendburimeve te naftes" do te thote te gjitha ato praktika qe pranohen per gjithesist ne industrine nderkombetare te naftes si te mira, te sigurta, ekonomike dhe efikase ne kerkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve.

"Person" do te thote nje person fizik a juridik, partneritet, njesi korporate apo ndonje shoqate tjeter.

"Prodhim" do te thote nxjerra dhe disponimi i hidrokarbureve.

"Rezervuar" do te thote nje grumbullim i veçuar hidrokarburesh.

"Shqiperia" do te thote Republika e Shqiperise

"Zbulim" do te thote nje zbulim i hidrokarbureve i hasur ne pusin e pare te çpuar ne nje strukture, qe mund te nxirret ne siperfaqe me nje debit te matshem nga njesi matede konvencionale te testimit te industrise se hidrokarbureve.

"Zone Kontrate" do te thote zona brenda se ciles Kontraktori autorizohet te kerkoje, zhvilloje dhe prodrohe hidrokarbure nen nje Marreveshje Hidrokarburesh.

"Zhvillim" do te thote ndertimi dhe instalimi i pajisjeve per prodhimin e Hidrokarbureve dhe shpimi i puseve te shfrytezimit.

**Neni 3.**

## **Pronesia mbi Hidrokarburet**

Te gjitha depozitimet e hidrokarbureve qe egzistojne ne gjendjen e tyre natyrore ne shtrese, qe shtrihen brenda juridiksionit te Shqiperise, duke perfshire zonat detare, jane prone ekskluzive e Shtetit Shqiptar i cili perfaqesohet nga Ministria perkatese dhe te gjitha keto burime do te perdoren per dobine e popullit shqiptar.

### **Neni 4.**

## **Operacione Hidrokarburesh**

Ne perputhje me nenin 12.(2) dhe pervec rasteve te operacioneve te vleresimit te objektit te kryera nen dhe ne perputhje me nje Leje per vleresim objekti te leshuar ne perputhje me nenin 8, asne person nuk do te kerkoje, zhvilloje apo prodhoje hidrokarbure ne Shqiperi pa qene i autorizuar nga Ministria per ta bere kete sipas termave dhe kushteve te nje Marreveshje Hidrokarburesh.

### **Neni 5.**

## **Marreveshje Hidrokarburesh**

- (1) Ministria mundet, duke ju nenshruar paragrafit (2) te ketij neni, te hyje ne Marreveshje Hidrokarburesh me çdo Person, duke autorizuar ate Person sipas termave dhe kushteve te percaktuara ne kete Marreveshje, te kerkoje, zhvilloje dhe prodhoje hidrokarbure ne Zonen e Kontrates.
- (2) Ministria nuk do te lidhe Marreveshje Hidrokarbure me asnje Person neqoftese Ministria nuk bindet se Personi me te cilin do lidhet Marreveshja e Hidrokarbureve ka ose mund te siguroje burimet financiare dhe kompetencen teknike te kerkuar per te perm bushur detyrimet e Kontraktorit nen Marreveshjen e Hidrokarbureve.
- (3) Nje Marreveshje Hidrokarbure mund :
  - (a) T'i jape nje Kontraktori sipas termave dhe kushteve te percaktuara ne te:
    - (i) Te drejten ekskluzive per te kryer kerkimin brenda Zones se Kontrates per nje periudhe e cila perveç ndonje kohe shtese te kerkuar per te perfunduar punen e marre persiper per te vleresuar nje Zbulim, nuk do te kaloje 5 vjete gjithsej, pervecse kur Kontraktori bind Ministrine se egzistojne kushte specifike te cilat kerkojne nje periudhe me te gjate, atehere Kontraktorit mund t'i jepet nje periudhe qe nuk i kalon 7 vjete gjithsejt.
    - (ii) Te drejten ekskluzive per nje periudhe qe nuk i kalon 25 vjetet, per te zhvilluar dhe prodhuar rezervat e hidrokarbureve ne Zonen e Kontrates, ne perputhje me kushtet e nje Plani Zhvillimi te miratuar nga Ministria, si dhe

per te riperterire kete te drejte aty dhe ne masen qe parashikon Marrveshja e Hidrokarbureve.

- (iii) Te drejten per te ndertuar, shtrire dhe operuar tubacione ne Shqiperi, duke ju nenshruar kerkesave per te lejuar perdonimin e kapacitetit te tepert nga palet e treta, ne kushte tregetare dhe duke ju nenshruar kushteve te aplikueshme te cfardo traktati ne te cilin Shqiperia eshte pale, per t' i lidhur ato me tubacionet dhe paisjet e vendeve te tjera.
- b) T'i jape Kontraktorit te drejten e pronesise per pjesen e tij te hidrokarbureve te produhuara ne zonen e kontrates ne nje pike qe specifikohet ne Mareveshjen e Hidorkarbureve.
- c) I garanton Kontraktorit te drejten te shese apo te tregetoje, per eksport apo ndonje gje tjeter, Hidrokarburet per te cilat ai ka marre pronesine sipas Marreveshjes se Hidrokarbureve, perveç rasteve kur i nenshtrohet te drejtes se porosise ne kushte emergjence si dhe çdo detyrimi qe permban Marrveshja e Hidrokarbureve per te furnizuar ose per te kontribuar ne furnizimin e tregut lokal.
- d) Nje Marrveshje Hidrokarburesh, ne te cilen eshte pale nje investitor i huaj, mund te permbaje klauzola lidhur me stabilitetin e regjimit fiskal.
- e) Duke iu nenshruar ketyre masave mbrojtese dhe rezervimeve sic mund te perfshihen ne Marreveshjen e Hidrokarbureve, kjo Mareveshje mund t'i njohe Kontraktorit te drejten :
  - (i) te marre dhe te mbaje jashte vendit te ardhurat e shitjes ne monedhe te huaj te hidrokarbureve te cilat i ka marre ne zoterim sipas Marreveshjes se Hidrokarbureve dhe ti perdore keto te ardhura ashtu sic e gjykon te pershtatshme, duke ju nenshruar pageses se takses mbi te ardhurat dhe detyrimet te tjera ne Shqiperi.
  - (ii) te dergoje jashte vendit, ne monedhe te huaj te konvertueshme, fitimet e arritura nga Kontraktori nga shitja e Hidrokarbureve ne Shqiperi.
  - (iii) te hape dhe te perdore llogari te huaja bankare me qellim qe te paguaje per mallra, sherbime dhe personelin e kerkuar per kryerjen e Operacioneve te Hidrokarbureve nen Marreveshjen e Hidrokarbureve.
  - (iv) te konvertoje monedhen e huaj ne monedhe vendase sipas kursit me te favorshem te kembimit ne agjensite e autorizuara, per te permbushur detyrimet ne monedhe vendase qe lindin nga Operacionet Hidrokarbure.
- f) Kur nje Investitor i Huaj eshte pale ne nje Marreveshje Hidrokarburesh, te vendosen klauzola per zgjidhjen nga arbitrazhi nderkombetar te mosmarreveshjeve qe lindin prej ose qe lidhen me Marreveshjen;

- g) Perfshin klauzola te tjera qe mund te duken te nevojshme dhe te deshirueshme ne lidhje me kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure.

### **Neni 6.**

#### **Detyrimet e Kontraktorit**

Çdo Marreveshje Hidrokarburesh e lidhur nga Ministria do te permbaje ne nje forme te pershtatshme, te rene dakort midis paleve, angazhime nga Kontraktori:

- a) per te kryer Operacione Hidrokarburesh ne perputhje me kete Ligj, dispozitat ligjore ne fuqi "Per mbrojtjen e mjedisit" dhe ne perputhje me Rregulloret e nxjerra prej ketij Ligji dhe me praktikat e mira te industrise se naftes;
- b) per te raportuar ne Ministri zbulimin e Hidrokarbureve ne Zonen e Kontrates;
- c) per te pergatitur dhe per t'i paraqitur Ministrise per aprovim, ne rast te nje zbulimi komersial, planin e zhvillimit i cili do te :
  - (i) siguroje perdonimin me efikasitet dhe me dobi te rezervave te Hidrokarbureve te njehsuara nga Kontraktori;
  - (ii) kujdeset siç duhet per ruajtjen e mjedisit dhe mireqenien e njerezve qe banojne ne zonat ku kryhen Operacionet e Hidrokarbureve sipas mareveshjes;
- d) per te zhdemtuar Shtetin ose Ministrine ndaj gjithe pretendimeve te paleve te treta ne lidhje me plagosjet, humbjet ose demtimet qe rezultojne nga ndonje operacion i kryer nga Kontraktori ose nga ndonje nenkontraktor;
- e) per t'i dhene perparesi punesimit dhe kualifikimit te shtetasve shqiptare, si dhe mallrave dhe sherbimeve vendase, ne perputhje me klauzolat qe do te perfshihen ne Planin e Zhvillimit, ne masen qe ato jane kompetitive persa i perket cmimeve dhe te krahasueshme persa i perket cilesise.

### **Neni 7.**

#### **Autorizimi per Kontraktorin**

Kur nje Kontraktor ka lidhur Marreveshje Hidrokarburesh me Ministrine, Shteti do ti jape Kontraktorit ose te siguroje qe Kontaktorit t'i jepen te gjitha lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera te ligjshme te cilat, Kontraktori, mund te kerkoje ne menyre te arsyeshme per te mundesuar kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure ne perputhje me Marreveshjen e Hidrokarbureve.

### **Neni 8.**

### **Lejet per vleresimin e objektit.**

- (1) Ministria mund t'i jape Leje per vleresim objekti çdo personi, sipas termave dhe kushteve te parashikuara ne te, duke autorizuar mbajtesin e Lejes te ndermarre kerkim ne zonen e lejuar nepermjet studimeve ajoore, gjeofizike, gjeokimike, paleontologjike, gjeologjike, topografike, studimeve e vrojtimeve seizmike dhe interpretimit te tyre.
- (2) Vetem neqoftse nuk eshte paraqitur ndryshe ne Lejen e Vleresimit, kjo Leje:
  - a) Do te mbaroje ne fund te nje periudhe prej 2 vjetesh;
  - b) Nuk do te jete eksluzive
  - c) Nuk do te autorizoje shpimin e puseve te kerkimit
  - d) Nuk do t'i njohe mbajtesit te lejes ndonje te drejte preference per te hyre ne Marreveshje Hidrokarburesh me Ministrine.

### **Neni 9.**

### **Rregulloret dhe Kontratat Model**

- (1) Ne baze te ketij Ligji, Ministria mund te hartoje rregullore per ose ne lidhje me :
  - a) Rregistrimin e Kontraktoreve;
  - b) Menyren ne te cilen duhen te paraqiten nga Kontraktori raportet, te dhenat, informacioni dhe llogarite.
  - c) Masat lidhur me ruajtjen e burimeve te hidrokarbureve, sigurine, shendetin, mbrojtjen e mjedisit dhe shmangjen e rrjedhjeve, mbetjeve, ndotjes dhe aksidenteve;
  - d) Ndarjen e zonave me potencial hidrokarbur ne zona apo blloqe me numra;
  - e) Te drejten e perdorimit te tokave publike dhe private ne lidhje me operacionet e hidrokarbureve;
  - f) Çdo çeshtje tjeter ne lidhje me te cilen Ministria e konsideron se duhet te hartohen rregullore per ta bere te efektshem kete Lig;
- (2) Ministria here pas here mund te publikoje Marreveshje Model Hidrokarburesh.

### **Neni 10.**

### **E Drejta e Perdorimit te Tokes**

- (1) Ne baze te kushteve te specifikuara ne rregulloret e hartuara ne perputhje me nenin 9.1(e), do te gjykohet qe nje Kontraktori i eshte dhene, sipas dispozitave te ligjit "Per Token", e drejta per te hyre dhe perdorur toke publike ose private per te kryer Operacione Hidrokarburesh nen Marreveshjen e Hidrokarbureve ku Kontraktori eshte pale.
- (2) Nese Kontraktori nuk paguan kompesim kur i kerkohet, ai do t'i nenshtrohet gjobave te specifikuara ne rregulloret perkatese.

- (3) Per qellimet e ketij nenii "toke private" do te thote toke ne pronesi private dhe toke e dhene me qera apo ne perdonim nga Shteti.

### **Neni 11.**

#### **Njesimi**

Kur nje rezervuar hidrokarburesh ndodhet pjeserisht ne nje Zone Kontrate dhe pjeserisht ne nje zone tjeter Kontrate dhe kur Ministri i duket se mund te arrihet rritje e efektivitetit permes zhvillimit dhe operimit te perbashket ne ate rezervuar, Ministria do te kete te drejten t'i urdheroje kontraktoret te zhvillojne dhe operojne se bashku rezervuarin sipas nje marreveshje te lidhur prej tyre per kete qellim.

### **Neni 12.**

#### **Klauzola Tranzitore dhe Perjashtime.**

- (1) Per sa i perket marreveshjeve te pershkruara ne shtojcen bashkelidhur ketij Ligji (marreveshjet per detin), nga data ne te cilen ky Ligj hyn ne fuqi:
- a) çdo njera nga keto marreveshje do te konsiderohet se eshte lidhur ne menyre te ligjeshme nga Ministria sipas nenit 5 te ketij ligji dhe sipas paragrafit 12.(1) do te vazhdoje te jete e vlefshme dhe e detyrueshme ne perputhje me kushtet e saj.
  - b) çdo njera nga keto marreveshje konsiderohet qe referencat ndaj DPNG (ketu dhe me poshte do te kuptohet si Drejtoria e Pergjitheshme e Nafteve dhe Gazit) ose ndaj ndonje pasuesi te te drejtave te DPNG, i referohen Ministri.
  - c) pa patur parasysh interesat e pjesemarrjes qe ketej e tutje mund te merren nga ndonje pasardhes i te drejtave te DPNG, sipas marreveshjeve midis Kontraktorit dhe Ministri, DPNG dhe pasuesit e saj ne pronesi nuk do te jene pale ose nuk do te kene ndonje te drejte, pronesi ose interes ne asnjeren nga keto marreveshje.
- (2) Persa i perket zonave ku Albpetroli eshte duke kryer operacione kerkimi, zhvillimi dhe shfrytezimi te hidrokarbureve do te konsiderohet se Ministria ka hyre ne Marreveshje me Albpetrol-in duke e autorizuar ate te kryeje keto operacione ne perputhje me kete Marreveshje.

### **Neni 13.**

#### **Hyrja ne Fuqi e Marreveshjes Hidrokarbure.**

- (1) Nje marreveshje hidrokarburesh, ne zbatim te nenit 5 te ketij ligji, do te nenshkruehet nga Ministri i Industrise, Burimeve Minerare dhe Energjetike ose nga nje person i autorizuar me shkrim prej Tij.

(2) Nje marreveshje hidrokarburesh hyn ne fuqi pas miratimit ne Keshillin e Ministrave.

**Neni 14.**

Te gjitha dispozitat ligjore qe bien ne kundershtim me kete ligj, shfuqizohen.

**Neni 15.**

Ky ligj hyn ne fuqi 15- dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I KRYESISE  
Pjeter Arbnori**

**Tirane me 28.07.1993**

**Nr. i Ligjit : 7746**

## **SHTOJCE**

- 1) Marveshja "Per kerkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-se dhe Deminex Albanian Petroleum GMBH e ÖMV, me vendim te KM Nr. 152 date 20.04.1991
- 2) Marveshja "Per kerkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-se dhe Chevron International (Albania) Limited, me vendim te KM Nr. 334 date 10.09.1991
- 3) Marveshja "Per kerkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-se dhe Occidental of Albania Inc., me vendim te KM Nr. 360 date 21.09.1991
- 4) Marveshja "Per kerkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-se dhe AGIP (overseas) Ltd., me vendim te KM Nr. 376 date 11.10.1991
- 5) Marveshja "Per kerkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-se dhe Hamilton Oil (Albania), me vendim te KM Nr. 476 date 23.12.1991

